# VENDIM
**Nr. 968, datë 25.10.2013**

## PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E FINANCAVE TE KRYEMINISTRIA, TË PRONËS NR. 1/16, NË ZONËN KADASTRALE ZK 8160, ME EMËRTIMIN "GODINË E MINISTRISË SË FINANCAVE", ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN "DËSHMORËT E KOMBIT", NR. 1, TIRANË, PËR SISTEMIMIN ME MJEDISE PUNE TË KRYEMINISTRISË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 622, DATË 15.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË FINANCAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave te Kryeministria, të pronës nr. 1/16, në zonën kadastrale ZK 8160, me emërtimin "Godinë e Ministrisë së Financave", me vendndodhje në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë, sipas formularit të inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, planvendndodhjes dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin me mjedise pune të Kryeministrisë.

2. Prona nr. 1/16, në zonën kadastrale ZK 8160, me emërtimin "Godinë e Ministrisë së Financave", me vendndodhje në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", nr. 1, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 622, datë 15.9.2006 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

( Per inventarizimin e pronave te vecanta )

Institucioni i Pushtetit Qendror : Ministria e Financave
Bashkia : Bashkia Tirane
Fusha e perdorimit te Prones: Ambjente pune

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. rendor | Zona Kadastr & Indeksi i Hartes | Nr Pasu-rise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçnta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1. Ministria Financave | ZK 8160 | 1\16 | Ndertese | Godine e Ministrise se Financave<br>Adresa : Bul. "Deshmoret e Kombit", Nr.1, Tirane | 3,846.11 m2 | 3,456.89 m2 | Zyra pune te Ministrise se Financave | Ministria Financave | Ministria Financave | Godina e Ministrise se Financave eshte godine 3 (tre) kateshe + bodrum.<br><br>Kufizohet :<br>Ne veri: Bul. "Deshmoret e Kombit"<br>Ne jug: Shesh para Statistikes<br>Ne lindje: Rruge, Hotel "Rogner"<br>Ne perendim: Zyrat e Kryeministrise |

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE Sh=1:150

(PLANI I DIMENSIONUAR)



## PLANIMETRIA E KATIT TE PARE Sh=1:150
(PLANI I DIMENSIONUAR)



PLANIMETRIA E KATIT TE DYTE Sh=1:150

(PLANI I DIMENSIONIMIT)



TABELA E AMBIENTEVE (KATI I DYTE)

[illegible]